

Mimoza Hasani Plana

Metodat dhe praktikat e përkthimit të letërsisë shqipe

Përmbledhje

Përkthimi i letërsisë shqipe në gjuhët europiane përfshin metodologji dhe praktika të ndryshme. Ky rezultat rrjedh nga një hulumtim empirik i realizuar nëpërmjet intervistave me përkthyes të letërsisë shqipe nga vendet si Gjermania, Austria, Mali i Zi, Rumani, Çekia, Suedia, Rusia dhe Holanda, si dhe nga studimet teorike të përkthimit letrar. Nga metodologjitë dhe praktikat e përdorura për përkthimin e letërsisë shqipe janë treguar të suksesshme përkthimet idiomatike, bashkëpunuese, përkthimet me përshtatje stilistike, sintaksore dhe kulturore. Një prirje mbizotëruese e identifikuar në këtë hulumtim është përdorimi i praktikave dhe metodave të kombinuara nga përkthyesit, ku elemente nga qasje të ndryshme bashkohen për të përshtatur përkthimet nga teksti burimor në tekstin e synuar. Me gjithë përkushtimin e përkthyesve, disa vepra letrare shqipe paraqesin sfida të rëndësishme për përkthimin, veçanërisht ato që dallohen për gjuhën e pasur figurative dhe veçoritë dalluese të gramatikës shqipe dhe dialektit të gegërishtes. Rrjedhimisht, disa përkthyes i perceptojnë këto tekste si rezistente ndaj përkthimit efektiv në gjuhët e synuara, duke i konsideruar “të papërkthyeshme” ose të paarrtshme. Përkthimi i letërsisë shqipe është një përpjekje komplekse, ndaj kërkon përkthyes që përveç gjuhës shqipe, njohin historinë dhe kulturën shqiptare në përgjithësi.

Fjalë kyçe: *Letërsi shqipe, përkthim letrar, teksti burimor, gjuha e synuar, metodat e përkthimit, praktikat e përkthimit.*

Kompleksiteti i përkthimit letrar

Sfidat e natyrës së përkthimit letrar tejkalojnë ato të përkthimeve të tjera, duke qenë se bartja e një teksti nga një gjuhë në tjetrën përfshin një proces të shumanshëm. Ky proces, përtej bartjes së thjeshtë kuptimore, kërkon edhe bartje semantike, duke ruajtur elementet stilistike, gjuhën figurative, ritmin dhe kontekstin kulturor nga gjuha burimore në gjuhën e synuar. Një kompleksitet i tillë kërkon vëmendje të hollësishme ndaj detajeve, nga ana e përkthyesit. Teorikisht, procesi i përkthimit nënkupton transferimin e kuptimit të një teksti

nga gjuha origjinale, që njihet me termin “teksti burimor”, në një gjuhë tjetër në të cilën përkthehet dhe që njihet me termin “gjuhë e synuar”.¹

Realizimi efektiv i këtij procesi kërkon aftësinë e përkthyesit për ta shndërruar gjuhën burimore në gjuhën e synuar duke ruajtur integritetin letrar dhe kulturor, një detyrë që tejkalon thjesht zëvendësimin leksikor, Rrjedhimisht, përkthyesi përballet me sfidën e ruajtjes së besnikërisë ndaj tekstit origjinal. Ky nocion i “besnikërisë” ndaj tekstit burimor mbetet një temë e përhershme e diskutimit shkencor brenda sferës së studimeve të përkthimit letrar. Dilema që pason rreth kërkimit themelor është se a mund të përkthehen tekstet letrare në atë mënyrë që të bartin vlerat estetike dhe emocionet për audiencën e synuar siç mund t’i ketë përjetuar audiencë origjinale? Si rezultate të këtyre diskutimeve, arrijmë në këtë konkludim: përkthimi shpesh është i pamundur dhe përkufizohet si një detyrë ideale, por e pashpresë.²

Një pjesë e studuesve që trajtojnë shkencërisht këtë çështje e pranojnë sfidën e natyrshme në arritjen e besnikërisë absolute në përkthim dhe pajtohen se nuk mund të arrihet gjithmonë saktësia e plotë, por pranojnë se përkthimi i një teksti letrar nga gjuha burimore në gjuhën e synuar vërtet mund ta ruajë thelbin dhe karakteristikat e tij letrare bashkë me efektin emocional me praktikimin e disa metodave. Metoda e ekuivalencës gjen përdorim më të gjerë, meqë përkrahësit e kësaj teorie pranojnë kompleksitetin e përkthimit letrar, ndaj theksojnë nevojën e gjetjes së zëvendësuesve të duhur për të përcjellë në gjuhën e synuar kuptimin, emocionin dhe vlerat letrare të tekstit origjinal. Kjo arritje lehtësohet me vëmendjen e shtuar të përkthyesit nëpërmjet mundësive që krijon metoda e ekuivalencës: ekuivalencë semantike, që ka të bëjë me gjetjen e fjalëve ose frazave në gjuhën e synuar që përcjellin të njëjtin kuptim si ato në gjuhën burimore; ekuivalencë sintaksore, që ka të bëjë me ruajtjen e korrektësisë gramatikore; ekuivalencë pragmatike, e cila përfshin përshtatje të shprehjeve, idiomave dhe referencave kulturore nga gjuha origjinale në gjuhën e synuar; ekuivalencë estetike, e cila përfshin rikrijim të stilit, tonit, figurave letrare dhe ekuivalencë kulturore, e cila përfshin përshtatjen e transmetimit të kontekstit kulturor në gjuhën e synuar. Ndonëse kjo metodë mbetet e

¹ Jeremy Munday, *Introducing Translation Studies: Theories and Applications*, (Taylor & Francis Group, ProQuest Ebook Central, 2016), 8, <https://ebookcentral.proquest.com/lib/sheffield/detail.action?docID=4542283>

² Peter Fawcett, “Translation in the broadsheets”, në *The translator*, 6:2, 295-307, doi:10.1080/13556509.2000.10799070, 2000, 306, <https://doi.org/10.1080/13556509.2000.10799070>

diskutueshme në vlerësim, tashmë teoricienët e studimeve të përkthimit pohojnë se e kanë të vështirë t'u shpëtojnë modeleve të saj.³

Pavarësisht diskutimit të vazhdueshëm që vë në dilemë praktikimin e metodës së ekuivalencës, ajo ka gjetur zbatueshmëri në masë. Realizimi i rezultateve të suksesshme të përkthimit varet nga kompetencat gjuhësore dhe kulturore, si dhe nga aftësia kreative e përkthyesit. Përtej njohurive gjuhësore dhe konteksteve kulturore, në këtë proces kërkohet që përkthyesi të përdorë imagjinatën dhe aftësinë artistike për gjetjet e duhura në çaste bllokimi. Ndërkohë ky punim synon të paraqesë gjetjet e nxjerra nga një hulumtim empirik në lidhje me përkthimin e letërsisë shqipe në gjuhët europiane. Në mënyrë të veçantë, studimi thellohet në metodologjitë dhe praktikat e adoptuara nga përkthyes europianë – me origjinë nga vende si Gjermania, Austria, Mali i Zi, Rumania, Çekia, Rusia, Suedia dhe Holanda – në përkthimin e veprave letrare shqipe në gjuhët e tyre përkatëse. Kërkimi përfshin një hark kohor nga vitet 1980 të shekullit XX e në vazhdim, duke hedhur dritë mbi metodat dhe praktikat e përkthimit brenda këtij rrafshi.

Metodat dhe praktikat e përkthimit të letërsisë shqipe

Përkthimi i letërsisë përfshin një sërë metodash dhe praktikash. Nëpërmjet kërkimit empirik, të kryer nëpërmjet intervistave me përkthyes të specializuar në letërsinë shqipe, kemi dalluar përhapjen e metodologjive hibride, përmes të cilave përkthyesit bashkojnë elemente nga qasje të ndryshme për t'i përshtatur përkthimet e tyre sipas nevojave dhe veçorive të tekstit burimor ashtu edhe të audiencës së synuar. Për më tepër, këta përkthyes përdorin edhe praktika hibride, me disa mjete pune dhe strategji efektive për përkthimet e tyre. Ndër qasjet mbizotëruese ndaj përkthimit letrar janë përkthimi idiomatik, përkthimi bashkëpunues, përkthimi kulturor dhe përkthimi me përshtatje, e ky i fundit është veçanërisht i dallueshëm. Pjesë përbërëse e përpjekjeve të tyre të suksesshme të përkthimit janë praktika të tilla si analiza e ngushtë e tekstit, kërkimi kontekstual, saktësia gjuhësore, përpjekjet bashkëpunuese dhe pjesëmarrja aktive në seminare dhe konferenca letrare që synojnë zhvillimin profesional. Megjithatë, vlen të theksohet se pavarësisht gjithë këtij angazhimi të përkthyesve, disa vepra letrare shqipe paraqesin sfida të mëdha për përkthimin, veçanërisht ato të karakterizuara nga gjuha e pasur figurative dhe veçoritë karakteristike të gjuhës shqipe. Rrjedhimisht, disa përkthyes i perceptojnë tekstet e tilla si rezistente ndaj përkthimit efektiv në gjuhët e

³ Rimbaud's Rainbow, *Literary translation in higher education*, edited by Peter Bush, and Kirsten Malmkjaer, John Benjamins Publishing Company, 1998, ProQuest Ebook Central, 23, <http://ebookcentral.proquest.com/lib/sheffield/detail.action?docID=730706>.

synuara, me një fjalë si të papërkthyeshme – të paarritshme. Nga këto tekste letrare, veçohen poezitë e poetit Lasgush Poradeci.

Përkthimi i bazuar në hulumtim

Brenda kompleksitetit të përkthimit letrar, përkthyesit përdorin një kombinim metodash dhe praktikash për të përcjellë në mënyrë efektive bukurinë dhe emocionin e tekstit letrar në gjuhën e synuar. Kjo përpjekje shpesh paraqet sfida të mëdha, duke përfshirë vështirësitë për përkthimin e “fjalëve të papërkthyeshme” ose koncepteve specifike kulturore shqiptare. Për shembull, përkthimi në gjermanisht i veprave të shkrimtarit shqiptar Martin Camaj (1925-1992) përbënte vështirësi të konsiderueshme për shkak të veçorive të stilit që ai përdor në të shkruar. Përkthyesi i njohur gjerman i letërsisë shqipe, Hans Joachim Lanksch (1943-2019), i cili filloi përkthimin e letërsisë shqipe pasi që gjatë një hulumtimi për studimet e sllavistikës hasi në kulturën shqiptare të Malit të Zi dhe e tërhoqi mënyra e mbijetesës shqiptare në Mal të Zi, sqaron se sfidat e tij në përkthimin e veprës së Camajt nuk ishin për shkak të morfologjisë dhe fonologjisë së gegnishtes, të cilën ai pohon se mund ta përvetësosh me lehtësi relative, por problemi ishte te *frazologjia e gegnishtes camajane*. Ndërsa, veprën e poetit Lasgush Poradeci, Lanksch e sheh si sfidë të pakapërcyeshme, derisa në intervistë pohon se “*Lasgush Poradeci, për mua është i papërkthyeshem*”.⁴ Një vlerësim i tillë nënvizon kompleksitetin e përkthimit të letërsisë shqipe dhe vështirësitë që ndesh përkthyesi kur përballet me tekste të karakterizuara nga veçori gjuhësore dhe kulturore të cilat pamundësojnë “përkthimin besnik” në kontekste të tjera gjuhësore dhe kulturore. Që nga vitet 1980 dhe 1990 të shekullit të kaluar, Lanksch filloi përkthimin e veprës letrare shqipe, duke u fokusuar në krijimtarinë e autorëve që konsideroheshin të panjohur për lexuesit e huaj, kryesisht shkrimtarë që kishin duruar persekutimin nën diktaturë ose ishin marginalizuar nga regjimet politike jugosllave. Ndër këta shkrimtarë veçohen Frederik Rreshpja, Zef Zorba, Kasëm Trebeshina, Primo Shllaku, Visar Zhiti, Mihal Hanxhari, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Din Mehmeti dhe Rrahman Dedaj. Gjithë këtë vëllim teksti, Lanksch përmend se e ka përkthyer duke përdorur mundësitë që kishte në dispozicion nga gjuha e tij amtare. “Përkthyesi duhet të punojë me materialin e gjuhës së tij amtare që ndryshon nga ai i gjuhës së origjinalit në shumë vështrime. Mirëpo, nëse teksti i përkthyer humbet vlerën letrare të origjinalit, nuk ka vlerë përkthyesi”.⁵

⁴ Mimoza Hasani Pllana, “Studimet ballkanike, albanologjike dhe përkthimi i letërsisë shqipe në Gjermani”, *Kultplus*, (Prishtinë, 10 mars 2019), <https://www.kultplus.com/intervista/%EF%BB%BFstudimet-ballkanike-albanologjike-dhe-perkthimi-i-letersise-shqipe-ne-gjermani/>

⁵ Ibid.

Praktika e përkthimit e bazuar në hulumtim shfaqet edhe te përkthyesi austriak Kurt Gostentschnig. Kërkimi i tij shtrihet në kontekstin historik dhe social, në marrëdhëniet austro-shqiptare. Në intervistë me të, Gostentschnigg rrëfen se si filloi të përkthente letërsinë shqipe në gjuhën austriake. “Shqipja është e dashura ime e vjetër. Historia e shqiptarëve dhe e marrëdhënieve austro-shqiptare është në mendjen time, ndërsa gjuha shqipe ka hyrë në zemrën time. Kur, gjatë ekskursionit universitar në Shqipëri në vitin 1989, e dëgjova për herë të parë tingullin e ëmbël të shqipes, rashë menjëherë në dashuri me të. Fillova që ditën e parë të shënoja fjalët e para në një fletore të vogël. Me t’u kthyer në Austri, fillova të mësoja për ditë në mënyrë autodidakte me një libër mësuesor të shqipes. Ndonëse i stërlodhur nga puna fizike me vëllain tim, në fushën metalurgjike, në verën e vitit 1990, uleshja për ditë në darkë të kryeja të paktën një mësim. Gjatë qëndrimeve të mia të mëvonshme në Shqipëri, mbledhja fjalë të urta nga veriu deri në jug, përsëri në një fletore të vogël dhe i “çmendja” gjuhëtarët shqiptarë, si p.sh. Ali Dhrimon, me pyetjet e mia tepër të hollësishtme, këmbëngulëse, lidhur me pasaktësinë, kontradiktat, në librat mësuesorë dhe gramatikorë. Tani, puna e përkthimit dhe hartimi i shkrimeve të mia në shqip, më mundësojnë ta ushqej këtë dashuri të ëmbël.”⁶ Përafërsisht njësoj, përkthimi i bazuar në hulumtim dhe kontekstualizim është gjithashtu praktikë e përkthyesit çek Přemysl Vinš. Vinš kujton se përkthimi i letërsisë shqipe lindi nga pasioni i tij për historinë dhe kulturën shqiptare. “Si fëmijë kërkoja çdo informacion për Shqipërinë, që në atë kohë konsiderohej në Çeki si vend i panjohur dhe pak i mistershëm. Duke marrë parasysh se që nga koha e fëmijërisë lexoj shumë, kohën e lirë e kaloja në bibliotekën e lagjes sonë. Dhe atje, një ditë, kam gjetur përkthimin çek të romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” nga Ismail Kadare. Ky roman më ka befasuar, në atë kohë e konsiderova si një dritare të vogël, nëpërmjet së cilës mund të kuptoja disa tipare të mentalitetit shqiptar. Natyrisht, më vonë, kuptova se Kadareja përdor dhe punon me disa stereotipe me të cilat shqiptarët duan të krenohen dhe me të cilat mund të tërheqin vëmendjen te lexuesi i huaj, por sigurisht ky libër, duke qenë i pari libër i letërsisë shqipe, më ndikoi shumë. Romanet e Kadaresë, sepse leximi i disa prej romaneve të autorit, erdhi natyrisht, më shërbenin pak si një mjet për të njohur kulturën dhe historinë e kombit shqiptar.”⁷

Hulumtimi historik ndërlidhet me përkthimin letrar, veçanërisht kur përkthehen tekste që ndodhen brenda konteksteve të veçanta historike, siç ishte

⁶ Mimoza Hasani Pllana, *Shtegtimi i Shqipes në Europë - Konteksti Albanologjik, Letrar dhe Antropologjik*, (Prishtinë, Olymp, 2019), 23.

⁷ Mimoza Hasani Pllana, “Studimet e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Karlit në Pragë”, *Kultplus*, (Prishtinë, 1 korrik, 2019), <https://www.kultplus.com/intervista/studimet-e-gjuhes-dhe-letersise-shqipe-ne-universitetin-e-karlit-ne-prage>

rasti i komunizmit në Shqipëri dhe në këtë rast krahasimi me komunizmin në Çeki. Hulumtimi historik i ndihmon përkthyesit të kuptojnë kontekstin kulturor në të cilin është krijuar një vepër letrare, në këtë rast, kjo përfshin njohjen e ideologjive politike dhe lëvizjeve kulturore që mund të kenë ndikuar te autori dhe teksti. Duke fituar njohuri për aspektin historik të tekstit burimor, përkthyesi mund të përcjellë më saktë nuancat emocionale në gjuhën e synuar. Përkthyesit që kryejnë hulumtime të thella historike mund të shmangin pasaktësitë ose keqinterpretimet që mund ta dëmtojnë tekstin në aspektin etik, prirje e njohur si besnikëria e përkthimit ndaj tekstit origjinal. Ky lloj kërkimi luan një rol vendimtar në pasurimin e praktikës së përkthimit të letërsisë shqipe duke ofruar kontekst të vlefshëm, njohuri gjuhësore dhe kuptim kulturor. Praktika e përkthimit të Përemysl Vinš, e justifikon këtë koncept teorik, derisa ai pohon se: “gjithmonë merresha më shumë me historinë, ndërsa letërsia shqiptare ishte diçka si shtesë, më tepër një pasion. Më pëlqen kur në veprat letrare pasqyrohen ngjarje reale historike. Pikërisht këtë lloj librash e kërkova në fillim të kontakteve të mia me letërsinë shqipe. Fokusohem në periudhën e regjimit komunist në Shqipëri dhe një nga qëllimet e mia është që publiku çek të kuptonte sa e ndryshme ishte përvoja shqiptare me komunizmin, në krahasim me atë çeke ose çekoslllovaqe. Edhe për këtë qëllim, pra për të kuptuar rebusin e komunizmit shqiptar, më shërbeu letërsia, sepse ajo pranohet më lehtë nga publiku i gjerë, në krahasim me studimet historike në revistat shkencore. Prandaj para disa vitesh kam përkthyer tregimet e njohura të Ylljet Aliçkës dhe gëzohem nga fakti se edhe me këtë botim modest, por relativisht të suksesshëm arrita atë qëllim – disa lexues më kontaktuan për të më pyetur nëse përshkrimet në librin e Aliçkës janë fantazia e autorit ose kështu u duk realiteti i jetës në Shqipërinë komuniste. Në Çeki jemi ndoshta tre ose katër njerëz, që në ndonjë mënyrë e njohim letërsinë shqipe, historinë e saj dhe që në mënyrë aktive e lexojnë letërsinë shqipe dhe përpiqemi edhe ta përkthejmë. Pra, këto mësimet unë i mora përsipër dhe duhet të punoja shumë, që të mund të plotësoja me dinjitet këtë detyrë, tejet të vështirë në fillimet e mia.”⁸

Krahas historisë, çështjeve shoqërore dhe zakoneve tradicionale, muzika është ndër faktorët që i kanë tërhequr përkthyesit letrarë të hulumtojnë letërsinë shqipe dhe ta përkthejnë në gjuhën e tyre. Letërsia dhe muzika si dy forma të shprehjes artistike shpesh reflektojnë dhe plotësojnë njëra-tjetrën brenda një kulture. Një përkthyes që vlerëson muzikën e një populli mund të përpiqet të përcjellë të njëjtën ndjenjë artistike në përkthimet e tij, duke nxitur një lidhje më të thellë midis dy formave të artit. Kjo lidhje është me përkthyesin suedez Ullmar Qvick, i cili gjatë intervistës kujton motivet që e shtynë të njohë dhe të përkthejë letërsinë shqipe, madje të krijojë fjalorin e parë shqip-suedisht, si mjet pune për përkthimin e letërsisë dhe më gjerë. “Dëgjova muzikën

⁸ Ibid.

shqiptare, sidomos këngët qytetare shkodrane. Ndjeva një ngrohtësi dhe emocion për këtë popull të vogël, të mënjanuar, të shtypur, të tradhtuar. Ishte muzika e bukur dhe ndjenja ime e drejtësisë, së bashku, që më bënin të mendoj se ky popull meriton një fat më të mirë se sa të vazhdojë të bëhet viktimë e politikës ndërkombëtare, e cila rrallë merr përsipër interesat e popujve të keqtrajtuar nepër shekuj.”⁹ Nga kjo përvojë kuptohet se duke njohur muzikën e një kulture të caktuar, një përkthyes fiton njohuri në kontekstin kulturor, madje kjo përvojë mund t'i shërbejë përkthyesit si frymëzim të gjejë shprehje figurative nga tekstet e këngëve, t'i përdorë ato në përkthime letrare.

Përshtatja kulturore, bashkëpunimi dhe redaktimi

Përkthimi i letërsisë shqipe shpesh kërkon përshtatje kulturore për të përcjellë emocionin e tekstit origjinal në gjuhën e synuar. Përkthyesit mund të kenë nevojë të gjejnë zgjidhje të ndryshme krijuese për të kapërcyer sfidat gjuhësore dhe kulturore që mund të hasin gjatë përkthimit, si gjetja e shprehjeve ekuivalente ose përshtatja e zakoneve kulturore të vendit të origjinës së shkrimtarit me kulturën e vendit në gjuhën e të cilit do të përkthehet teksti. Vërehet se përkthyesit bëjnë edhe zgjedhje stilistike për të përcjellë fjalët figurative të shkrimtarit në gjuhën e synuar me përshtatje kulturore. Për të arritur këto zgjidhje, përkthyesit përdorin mjete letrare për përkthim, si fjalori ose konsultimet me përkthyesit, për të përshtatur fjalët, strukturën e fjalisë ose për të përcjellë tonin dhe gjendjen emocionale të tekstit origjinal në gjuhën europiane.

Bashkëpunimi dhe konsultimi: shumë përkthyes bashkëpunojnë me kolegë, redaktorë dhe ekspertë të çështjeve për të rafinuar përkthimet e tyre dhe për të adresuar çdo paqartësi apo sfidë në tekst.

Konsultimi me njohës të gjuhës burimore mund të sigurojë njohuri të vlefshme dhe të ndihmojë në sigurimin e saktësisë dhe autenticitetit në përkthim. Marius Dobrescu, përkthyesi rumun i letërsisë shqipe, konkretisht i veprës së gjerë të shkrimtarit shqiptar Ismail Kadare, rrëfen praktikën e tij të punës. Ai pohon se përkthimin e një libri e sheh si provim në matematikë. Çdo fjali është një ushtrim, çdo frazë një problem në vetvete dhe të gjitha këto kërkojnë një zgjidhje. “Duhet punuar tamam si në matematikë: me këmbëngulje dhe përkushtim. Fjalorin e përdor shumë rrallë. Disa herë kuptimin e një fjale e kam shumë të qartë në shqip, gati-gati e imagjinoj objektin ose veprimin respektiv, por në rumanisht më vjen vështirë ta shpreh. Nuk e gjej fjalë koresponduese më të mirë. Kjo ndodh rrallë, shumë rrallë. Atëherë shkoj në dhomën tjetër dhe e pyes gruan: ja, nuk e di siç i thonë kësaj

⁹ Mimoza Hasani Pllana, *Shtegtimi i Shqipes në Europë - Konteksti Albanologjik, Letrar dhe Antropologjik*, vep. cit., 244.

rumanisht? Dhe ajo më ndihmon. Maria ka mbaruar për gjuhë-letërsi rumune, është gazetare dhe ndihma e saj është shumë e vlefshme për mua. Kur përkthej një tekst nuk më intereson fare kuptimi mot-a-mot i frazës në gjuhën rumune dhe e riformuloj rumanisht, disa herë më zë të lartë, për ta dëgjuar si tingëllon.”¹⁰ Natyra e përkthimit është e tillë që praktikuesit (përkthyesit) janë nxënës të përrjetshëm, të trajnuar me metoda informale dhe janë të lidhur me kolegët për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave, pasi detyra e përkthyesit është po aq e pafundme sa ajo e lexuesit.¹¹ Në praktikën e përkthimit të Dobreskos, rishikimi dhe redaktimi i tekstit të përkthyer është i rëndësishëm. Në teori, rishikimi dhe redaktimi fillon pasi të përfundojë përkthimi i draftit fillestar, më pas përkthyesi rishikon dhe redakton përkthimin për të përmirësuar qartësinë e leximit dhe të kuptuarit të tekstit. Ky proces mund të përfshijë disa rishikime, bazuar në vëzhgimet personale ose reagimet nga redaktorët dhe kolegët e përkthimit. Këtë përkufizim teorik, Dobresko e realizon në praktikë si vijon: “pasi e mbaroj veprën, e lë disa javë të “çlodhet”, shlodhem edhe unë, dhe pastaj e rilexoj, ndreq gabimet dhe riformuloj frazat që nuk më duken të kënaqshme. Jam shumë ambicioz dhe ata të shtëpisë botuese me të cilën bashkëpunoj, e kam fjalën për “Humanitas”, botuesi më i mirë tek ne, thonë për tekstet e mia që janë shumë korrekte edhe nga ana gramatikore, edhe nga ajo stilistike.”¹²

Koncepti teorik i njohur si përshtatje kulturore ka gjetur zbatueshmëri për përkthimin e letërsisë shqipe edhe në gjuhën holandeze. Roel Schuyt, i njohur për përkthimin e letërsisë ballkanike në holandisht, rrëfen se përkthimin e letërsisë shqipe e ka nisur pas një kontakti dhe njohjeje me kulturën ballkanike në përgjithësi.

Ai rrëfen se me kulturën shqiptare filloi të përshtatet pasi njohu muzikën. “Në fillim më ka pëlqyer muzika folklorike bullgare dhe rumune (më 1956 babai kishte marrë në Bullgari pllaka muzikore 78rpm. të gramafonit) dhe pjesë muzikore nga kombësi të ndryshme të Jugosllavisë. Më vonë, fillova të interesohem për muzikën greke dhe shqiptare – p. sh. polifoninë e jugut të Shqipërisë, muzikën e Nexhmije Pagarushës nga Kosova, dhe regjistrimet e vjetra të Tefta Tashko Koços (sot, pianoja e saj është e ekspozuar në hapësirat e Muzeut Kombëtar Historik në Tiranë). Emri i fundit më përkupton një zbulim të veçantë: ekzistencën e këngëve urbane lirike të Shqipërisë, që posedojnë të

¹⁰ Mimoza Hasani Pllana, *Shtegtimi i Shqipes në Europë - Konteksti Albanologjik, Letrar dhe Antropologjik*, vep. cit., 221.

¹¹ Chantal Wright, *Literary Translation*, Taylor & Francis Group, 2016. ProQuest Ebook Central, 163,

<http://ebookcentral.proquest.com/lib/sheffield/detail.action?docID=4542052>

¹² Mimoza Hasani Pllana, *Shtegtimi i Shqipes në Europë - Konteksti Albanologjik, Letrar dhe Antropologjik*, vep. cit., 222.

njëjtat kualitete si ato të Rusisë, Francës, Italisë dhe vendeve të Ballkanit, si Rumanisë, Bullgarisë dhe Greqisë.”¹³

Duke qenë se veprat letrare janë të lidhura me kontekstet kulturore të vendit, duke pasqyruar zakonet, vlerat artistike dhe muzikore të shoqërive përfaqësuese, përkthyesit i hetojnë këto nuanca kulturore në mënyrë kreative meqë mund të gjejnë një qasje strategjike se si të përshtasin disa elemente të tekstit letrar me përmbajtje kulturore nga gjuha burimore në gjuhën e synuar, për të krijuar të njëjtin emocion në audiencën e re. Me këtë qasje praktike, përkthyesi beson se i qëndron besnik tekstit origjinal. Krahas praktikës së përshtatjes kulturore, praktika e bashkëpunimit rezulton të jetë më e fuqishme në rastin e këtij hulumtimi. Schuyt e vlerëson bashkëpunimin me përkthyesit e letërsisë shqipe, përkatësisht përkthyesit e veprës së Kadaresë në frëngjisht, Jusuf Vrioni dhe Tedi Papavrami. Këta dy përkthyes, Schuyt i kujton si burim inkurajimi për përkthimet e tij në holandisht. “Në fillim më ndihmuan shumë përkthimet e Vrionit, dhe mëpastaj gjithashtu përkthimet e pasardhësit të tij Tedi Papavrami. Në disa raste (si në rastin e prozës Aksidenti), nuk kishte fare tekst në gjuhën frënge, kështu që më duhej ta përktheja novelën pa u mbështetur në përkthimet frënge. Mund të konfirmoj se përkthyesit Jusuf Vrioni dhe Tedi Papavrami kanë bërë një punë të shkëlqyeshme për t’i bërë të njohura veprat e Kadaresë në të gjithë botën. Pothuajse të gjitha versionet në gjuhët e tjera, përpos frëngjishtes janë të bazuara në përkthimet e tyre. Kur kam bërë krahasimin e versionit në gjuhën frënge me tekstet origjinale, kam vërejtur se versionet në gjuhën frënge në disa raste mund të jenë “zbukuruar”.”¹⁴

Gjuha figurative, rima dhe ritmi

Për shkak të nuancave kuptimore që japin figurat stilistike, disa zhanre pësojnë humbje të vlerave letrare gjatë procesit të përkthimit. Ky fenomen është veçanërisht i theksuar te zhanri i poezisë, meqë figura stilistike gjen përdorim të theksuar. Për këtë fakt, përkthyesit e letërsisë shqipe përballen me sfidën e madhe që paraqet kompleksiteti i gjuhës figurative, por edhe rimës dhe ritmit të poezisë. Këto elemente paraqesin sfida të rëndësishme për transferimin besnik të teksteve nga shqipja në gjuhën e synuar. Duke u mbështetur në përvojën e tij të gjerë të përkthimit, studiuesi dhe përkthyesi rus Aleksandër Novik, rrëfen sfidën personale për përkthimin e letërsisë shqipe në gjuhën ruse duke thënë se: “shumë të vështira janë përkthimet e frazeologjizmave, metaforave, fjalëve të urta, proverbave; teksteve dhe fjalëve dialektore.”¹⁵

Ndërsa përkthyesi malazez Jovan Nikolaidis shkon përtej këtyre vështirësive duke thënë se: “është vështirë që të përkthehet autori shqiptar,

¹³ Ibid., 140.

¹⁴ Ibid., 141-142.

¹⁵ Ibid., 204.

ndonëse gjuha shqipe është e bukur, melodike, është gjuhë e shpirtit dhe proverbave, ndaj me të edhe melodia rrjedh pa ndalë. Fjalët dhe tonet janë në përputhje, por vështirësitë e përkthimit vijnë sepse gjuha shqipe ka ndërtim lingistik ndryshe nga gjuhët sllave – është e kundërt me to”¹⁶

Studimet teorike të përkthimit, shpjegojnë se përkthyesit letrarë ndeshen me pengesa kur marrin për të përkthyer gjuhën figurative, rimën dhe ritmin. Kjo sfidë lind nga kompleksiteti i ruajtjes së integritetit artistik dhe gjuhësor të tekstit origjinal duke siguruar njëkohësisht qartësi dhe koherencë në gjuhën e synuar. Një shqetësim i veçantë është përkthimi i metaforës, i cili përbën një problem themelor për shkak të nuancave të dallueshme kulturore dhe gjuhësore që lidhen me kuptimin e interpretimeve të figurës letrare. Kuptimi i një metafore shpesh lidhet me kontekstin kulturor në të cilin e ka origjinën, duke rezultuar në interpretime të ndryshme nëpër gjuhë dhe kultura të ndryshme. I tillë është rasti i metaforave që përfshijnë kafshët, si është shembulli i maces, “she is a cat” (ajo është një mace), që në kulturën angleze mund të interpretohet dhe kuptohet si diçka “jo e mirë, keqdashëse”, ndërsa në kulturën gjermane një “katze” (mace) nuk shoqërohet me keqardhje apo keqdashje, por me hir dhe shkathtësi, prandaj një përkthim fjalë për fjalë të fjalisë angleze “she is a cat”, në gjermanisht nuk do të komunikonte kuptimin metaforik që komunikon në anglisht.¹⁷ Vështirësitë e kësaj natyre vijnë nga kuptimet e dyta të fjalëve figurative të bazuara në referenca kulturore dhe shprehje idiomatike që mund të mos kenë një kuptim barasvlershëm në gjuhën e synuar, ndërsa përkthyesit duhet të vendosin një ekuilibër midis qëndrimit besnik ndaj kuptimit figurativ të tekstit në gjuhën origjinale dhe kuptimi figurativ në gjuhën që përkthehet.

Integriteti artistik

Integriteti artistik i referohet respektimit të parimeve dhe vlerave artistike pa kompromis përballë presioneve të jashtme si interesat komerciale, pritshmëritë sociale apo kritikën. Përkthyesi i qëndron besnik vizionit të tij artistik për t’i ofruar lexuesit një vepër të përkthyer që pasqyron besnikëri ndaj tekstit origjinal dhe sinqeritet në shprehjen artistike edhe nëse i duhet të përballet me vështirësitë e përfitimit financiar, që vlerësohet si mjaft tundues. Qasja e përkthimit duke ruajtur integritetin artistik nënkupton se një variant i tekstit i paraqitur në mjedisin e gjuhës së synuar, bart një mesazh për lexuesin që është sa më afër atij origjinal.¹⁸

¹⁶ Mimoza Hasani Pllana, “Letërsia shqipe në gjuhën malazeze”, *Kultplus*, (5 gusht 2019), <https://www.kultplus.com/intervista/letersia-shqipe-ne-gjuhen-malazeze/>

¹⁷ Mary Snell-Hornby, *Translation studies an integrated approach*, (John Benjamins publishing company Amsterdam/Philadelphia, 1988/1995), 56.

¹⁸ Jin Di, *Literary Translation: Quest for Artistic Integrity*, (Taylor & Francis Group, ProQuest Ebook Central), 203, 550.

Në procesin e përkthimit letrar respektimi i parimeve etike është po aq i rëndësishëm sa edhe kompetencat e dijes dhe të krijimtarisë. Kujdesi etik për përkthyesit seriozë përqendrohet në nevojën për saktësi dhe besnikëri ndaj tekstit në variantin origjinal. Për përkthyesin Roel Schuyt, dy prej detyrave themelore të përkthyesit në planin etik janë: “a) të kuptojë plotësisht tekstin origjinal dhe b) të transferojë tekstin në gjuhën që po e përkthen në atë mënyrë, që përmbajtja të mbetet e paprekur.”¹⁹ Tutje, lidhur me parimet etike në procesin e përkthimit, Schuyt vlerëson si në vijim: “në procesin e përkthimit, duhen bartur dhe përpunuar, të gjitha rregullat gramatikore dhe të gjitha praktikat letrare, edhe të së folmes së përditshme të respektohen gjatë procesit të përkthimit. Këto janë kushte thelbësore për ta krijuar / rikrijuar një tekst që i ngjan përmbajtjes origjinale, i cili pa pengesa mund të lexohet si një vepër arti e veçantë.”²⁰

Etika e përkthimit përfshin respektimin e së drejtës së autorit të tekstit të përkthyer, inkurajimin dhe promovimin e qasjeve të përgjegjshme në praktikën e përkthimit të letërsisë nga një gjuhë në tjetrën.

Për një përkthim të suksesshëm, studiuesit e përkthimeve letrare, e justifikojnë edhe pragmatizmin e përkthyesit, madje në disa raste e konsiderojnë vendimtare në përkthimin e teksteve, sidomos kur kërkohet ekuilibri i besnikërisë dhe rrjedhshmërisë së tekstit. Mbështetësit e qasjes pragmatike vlerësojnë se ndërsa besnikëria ndaj tekstit origjinal është e rëndësishme, rrjedhshmëria e tekstit në gjuhën e synuar është gjithashtu e rëndësishme.

Në këto raste, përkthyesve u kërkohet të marrin vendime strategjike për t'u larguar nga përkthimi i fjalëpërfjalshëm, në mënyrë që të përçojnë kuptimin e synuar në mënyrë efektive, pa sakrifikuar cilësinë e përgjithshme të përkthimit. Në disa studime mbi përkthimin letrar, gjejmë rekomandime se pragmatika duhet të futet si një disiplinë e rëndësishme e cila mund të kontribuojë në studimet e përkthimit.²¹ Propozimet e kësaj natyre ende janë në nivel diskutimesh.

Përfundim

Rezultatet e këtij punimi nënvizojnë diversitetin në metodat dhe praktikat e përkthimit të përkthyesve të cituar, duke zbuluar se çdo përkthyes përdor

<http://ebookcentral.proquest.com/lib/sheffield/detail.action?docID=1702413>.

¹⁹ Mimoza Hasani Pllana, *Shtegtimi i Shqipes në Europë - Konteksti Albanologjik, Letrar dhe Antropologjik*, (Olymp, Prishtinë, 2019), 142.

²⁰ Ibid., 142-143.

²¹ Bahaa-eddin A. Hassan, *Literary Translation: Aspects of Pragmatic Meaning*, (Cambridge Scholars Publishing, 2011, 89, ProQuest Ebook Central),

<http://ebookcentral.proquest.com/lib/sheffield/detail.action?docID=1133163>

metoda të përkthimit të karakterizuara nga spontaniteti dhe zgjedhja individuale. Përkthyesit e letërsisë shqipe të anketuar në këtë grup kërkimor nuk i perceptojnë drejtpërdrejt studimet teorike mbi përkthimin letrar si një pikë referimi që do t'i lehtësonte përpjekjet e tyre për përkthim. Në vend të kësaj, këta përkthyes mbështeten në përvojat personale të lidhura me kulturën, historinë dhe gjuhën shqipe për të adoptuar metodologjitë dhe praktikat e tyre të përkthimit. Kështu, qasjet e tyre ndaj përkthimit janë thuajse të pavarura nga metodat e formalizuara të përkthimit, duke reflektuar kryesisht një mbështetje gjuhësore dhe kulturore të kontekstit shqiptar, të cilin shumica prej tyre e kanë njohur thuajse rastësisht.

Bibliografi

- Di, Jin. *Literary Translation : Quest for Artistic Integrity*, Taylor & Francis Group, ProQuest Ebook Central, 203.
<http://ebookcentral.proquest.com/lib/sheffield/detail.action?docID=1702413>.
- Fawcett, Peter. "Translation in the broadsheets", *The translator*, 6:2, 295-307, doi:10.1080/13556509.2000.10799070, 2000, <https://doi.org/10.1080/13556509.2000.10799070>.
- Hassan, Bahaa-eddin A. *Literary Translation : Aspects of Pragmatic Meaning*, Cambridge Scholars Publishing, 2011, Pro Quest Ebook Central,
<http://ebookcentral.proquest.com/lib/sheffield/detail.action?docID=1133163>.
- Hasani Pllana, Mimoza. *Shtegtimi i shqipes në europë - konteksti albanologjik, letrar dhe antropologjik*, Olymp, Prishtinë, 2019.
- "Studimet e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Karlit në Pragë", *Kultplus*, Prishtinë, 1 korrik, 2019, <https://www.kultplus.com/intervista/studimet-e-gjuhes-dhe-letersise-shqipe-ne-universitetin-e-karlit-ne-prage>.
- "Studimet ballkanike, albanologjike dhe përkthimi i letërsisë shqipe në Gjermani", *Kultplus*, Prishtinë, 10 mars 2019, <https://www.kultplus.com/intervista/%EF%BB%BFstudimet-ballkanike-albanologjike-dhe-perkthimi-i-letersise-shqipe-ne-gjermani/>.
- "Letërsia shqipe në gjuhën malazeze", *Kultplus*, Prishtinë, 5 gusht 2019, <https://www.kultplus.com/intervista/letersia-shqipe-ne-gjuhen-malazeze/>.

- Munday, Jeremy. *Introducing translation studies: Theories and applications*, Abingdon and New York: Routledge, (3rd edition), Across Languages and Cultures 14 (1), pp. 155–159 (2013), doi: 0.1556/acr.14.2013.1.8. 2012.
- *Introducing Translation Studies : Theories and Applications*, Taylor & Francis Group, ProQuest Ebook Central, 2016.
<https://ebookcentral.proquest.com/lib/sheffield/detail.action?docID=4542283>
- Rainbow, Rimbaud's. *Literary translation in higher education*, edited by Peter Bush, and Kirsten Malmkjaer, John Benjamins Publishing Company, 1998, 23, Pro Quest Ebook Central,
<http://ebookcentral.proquest.com/lib/sheffield/detail.action?docID=730706>.
- Snell-Hornby, Mary. *Translation studies an integrated approach*, John Benjamins publishing company Amsterdam/Philadelphia, 1988/1995.
- Wright, Chantal. *Literary Translation*, Taylor & Francis Group, 2016. ProQuest Ebook Central,
<http://ebookcentral.proquest.com/lib/sheffield/detail.action?docID=4542052>

SUMMARY

Methods and practices of translating Albanian literature

The translation of Albanian literature into European languages includes different methodologies and practices. This result derives from an empirical research carried out through interviews with translators of Albanian literature from countries such as Germany, Austria, Montenegro, Romania, Czech Republic, Sweden, Russia and the Netherlands, as well as from theoretical studies of literary translation. Among the methodologies and practices used for the translation of Albanian literature, idiomatic, collaborative translations, translations with stylistic, syntactic and cultural adaptation have been shown to be successful. A dominant trend identified in this research is the use of combined practices and methods by translators, where elements from different approaches are brought together to adapt translations from the source text to the target text. Despite the dedication of the translators, some Albanian literary works present significant challenges for translation, especially those that stand out for their rich figurative language and distinctive features of Albanian grammar and the Georgian dialect. Consequently, some translators perceive

these texts as resistant to effective translation into the target languages, considering them “untranslatable” or inaccessible. The translation of Albanian literature is a complex endeavor, so it requires translators who, in addition to the Albanian language, know Albanian history and culture in general.